REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 741/20
Data/Datum 20.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bushi, ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**08.10.2020**	**18.10.2020**	Nr. i lëndës: ***741/20***

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.10.2020, OE "Olti Trasing"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **741/20**, kundër njoftimit për **anulimte** kontrates, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndertimi i shkollës ne Nerodime"** me nr. të prokurimit: **656-20-3581-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Ferizaj (KF).**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurëtë hapur**, lloji i kontratës: **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **480,000.00€.**
SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së)
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Njoftimi per kontrate: 10.07.2020
Afati i hapjes : 03.08.2020 ora 11:00
Kriteret per dhënien e kontratës : Çmimi me i ulet
Vendimi i anulimit: 14.09.2020
Kerkesa per rishqyrtim: 21.09.2020
Vendimi per refuzim: ska

Dispozitat e shkelura te AK-së

Neni 1 i LPP-se;
Neni 7 i LPP-se;
Neni 59 i LPP-se;
Neni 69 i LPP-se;
Neni 62 i LPP-se;
Neni 40 i RrUOPP-se;
Neni 41 i RrUOPP-se;
Neni 44 i RrUOPF-se.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

- Është shkelur neni 62 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Përfundimi i aktivitetiti të prokurimit)) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, dhe nenit -

Është shkelur neni 44 i RRUOPP-së (Ndërprerja e procedurave të prokurimit). Nuk janë të paraparа arësyet të cilat ju i keni cekur në Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Anulim i aktivitetiti të prokurimitit publikuar në ueb faqen e platformes elektronike të KRFP-së me datë 14/09/2020;

Është shkelur: Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave

I. PARAQITJA E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM PRANË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 6
Pezullimi i aktivitetit të prokurimit

Paragrafi 6.3 Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 6.2 te këtyre rregullave. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Neni 8
Vendimi i Autoritetit Kontraktues

8.2. Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i detyrueshëm për autoritetin kontraktues dhe duhet të zbatohet menjëherë. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe ti komunikohet me shkrim, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Në rastet kur një zyrtar përgjegjës i prokurimit nuk lëshon një vendim ne lidhje me kërkesën për shqyrtim, Operatori Ekonomik ka te drejte qe te parashtroj një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Me kërkesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik do të vazhdoj me procedurat e shkëputura në paragrafin 8 te nenit 25 te LPP-se.

Si po shihet autoriteti kontraktues Komuna Ferezaj –Drejtoria e prokurimit fare nuk na ka dërguar Vendim - përgjigje në kërkesen tonë për rishqyrtim të dërguar më 21/09/2020

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të regullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve te prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoriteter kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet te prokurimit i cili nuk do te rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme per shkak te ngjarjeve objektive dhe që mund te demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit te autoritetit kontraktues dhe që nuk mund te parashikohen ne kohen e inicimit te aktivitetit te prokurimit por kjo duhet te behet se paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.
44. Ndërprerja e procedurave te prokurimit
44.1 Ne rast te vendimit te anulimit te procedurës se prokurimit, AK menjëherë do te
përgatise dhe do te dërgoj njoftimin tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës ku paraqiten arsyet
faktike dhe bazen ligjore te anulimit te tille.

44.2 AK duhet që "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ta ngrite ne platformë
te prokurimit elektronik si dokument shtesë nëpërmjet funksionit "shtoni dokument te ri".
44.3 AK duhet që "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ta bëje te njejten dite

pasi që te jetë dërguar njoftimi tek tenderuesit/kandidatët pjesëmarrës.
44.4 Pas skadimit te afatit kohor per parashtrim dhe shqyrtim te ankesave, do te përgatite
Njoftimin për Anulim te aktivitetit te prokurimit pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar
dhe njoftimin e tille do ta publikoje ne platformën e prokurimit elektronik.
44.5 Dorëzimi i njoftimin te anulimit te tillë ne KRPP dhe publikimi i njoftimit te tille nuk është i
nevojshem per kontratat me vlerë minimale.

44.6 Njoftimi për anulim për kontratat me vlerë të vogël dhe të mesme do të përgatitet në gjuhën
shqipe dhe serbe, ndërsa për kontratat me vlerë të madhe në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
44.7 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
(i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
(iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike komizë me më shumë se një OE - është më pak se 3;
(iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(v) numri i kandidateve te kualifikuar ne procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
(vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
(viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; ose
(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
(x) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformë elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i paripaueshëm sipas verifikimit nga KRPP;
(xi) nese eshte paraqitur nje gabim teknik ne platformen e prokurimit elektronik nga ndonje situate e paparashikuar dhe jashte kontrollit te AK dhe i cili gabim eshte i paripaueshem sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik
91
44.8 Procedura e prokurimit pas marrjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:
(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.
44.9 Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme:
(i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.
(ii) nëse AK ka shkaktuar një gabim teknik në platformë elektronike gjatë udhëheqjes së procedurës dhe i cili gabim është i paripaueshëm sipas verifikimit nga KRPP;
(iii) është paraqitur një gabim teknik ne platformen e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i paripaueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.10 Ne rast te anulimit bazuar ne rrethana dhe arsye te deklaruara ne kete nen, autoriteti kontraktues nuk do te kete asnje pergjegjesi ndaj tenderuesve, pjesëmarrësve ose kandidatëve

8/3

për anulim të një procedure të prokurimit, subjekt i dispozitave të Nenit 105, paragrafi 2.9 të LPP
në lidhje me kompensimin e ankuesit.
44.11 Në qoftë se një procedurë e prokurimit është anuluar dhe AK ende dëshiron të vazhdojë
me aktivitetin e prokurimit përkatës, AK do të fillojë një procedurë të re të prokurimit pa ndryshuar
numrin e prokurimit, por duke identifikuar atë me "Ri-tender".
45. Formularët Standard
45.1 AK do të përgatisë dokumentet e tyre të prokurimit duke përdorur

Në përfundim: të prezentimit të argumenteve përmes kësaj Ankese kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-së që I'i propozoi Panelit Shqyrtues të OSHP-së të aprovojnë Ankesën e Operatorit Ekonomik ekonomik "Olti Trasing" Shpk – Sheshi Bill Klinton, pr. Prishtinë, Rep. e Kosovës. dhe i tërë aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim dhe të urdhëhohet autoriteti kontraktues Komuna – Ferizaj Rr. Dëshmorët e Kombit 700000 Ferizaj Republika e Kosovës - Departamenti i Prokurimit të bie këtë:

V E N D I M

- MIRATOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik ekonomik Olti Trasing" Sheshi Bil Klinton, 10000 Prishtinë
- ANULOHET Vendimi, përkatësisht Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues – anulim i aktivitetit të prokurimit i publikuar në uebfaqen e platëformës elektronike të KRPP-së me datë 14/09/2020
- Të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që me kontratë publike për aktivitetin e larcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e operatorit ekonomik "Olti Trasing" SH. P. K. Sheshi Bil Klinton, 10000 Prishtinë.si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit.

Demet materiale:

Dëmet materjale janë të konsiderueshme që kanë të bëjnë me përgatitjen e dosjes së tenderit

Përgatitja Kërkesës për Rishqyrtim

Përgatitja e kësaj ankese.

Dëmet më të mëdha do t'i shkatohen Operatorit Ekonomik "Olti Trasing" Sh.p.k. Sheshi Bil Klinton Prishtinë nëse oferta nuk do të shpërblehet me kontratë publike për aktivitetin e lartëcekur të prokurimit.

Të gjitha dëmet materiale do të konstatohen në të ardhmën nga ekspertët e autorizuar ligjorë përkatës gjatë zhvillimit te procedurës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteret e kerkuara nga AK-ja (per pretendimet qe ka OE ankues):

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
1. Deklarata nën betim se OE, i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë sipas kërkesave të LPP- së neni 65. Për OE fitues kërkohet që para nenshkrimit të kontratës të dorëzoj 1.Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-(për tremujorin e fundit të vitit [deri ne datën e publikimit të Njoftimit per dhenie te kontrates] 2.Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK-së (për vitin 2019) 3. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit – origjinal apo e noterizuar.	**1. Deklarata nën betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. Për OE fitues kërkohet që para nenshkrimit të kontratës të dorëzoj 1.Dëshmi-Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj ATK-(për tremujorin e fundit të vitit [deri ne datën e publikimit të Njoftimit per dhenie te kontrates] 2.Dëshmi- Vërtetimi mbi kryerjen e obligimeve ndaj KK-së (për vitin 2019) 3.Vërtetimin e gjykatës ekonomike – origjinal ose kopje e noterizuar**
1.Çertifikata e Biznesit për veprimtari adekuate, 2.Çertifikata e TVSH-së,	**1.Çertifikata e Biznesit për veprimtari adekuate 2.Kopje-Çertifikata e TVSH,**
Kerkesa: **1. Operatori ekonomik duhet ti ofroje deshmi te kenaqshme AK se ka perfunduar pune te ngjashme jo me pak se 550,000.00 € ne tri vitet e fundit duke fillar nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.**	**Deshmia:** **1. Lista e kontratave (e nenshkruar dhe e vulosur)origjinale.Operatori ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate te ketij tenderi, te nenshkruar dhe vulosur nga OE, te deshmuar**

	me referenca apo raporte te pranimeve teknike te kontratave te kryera ne lemin e puneve te ngjashme, te cilat tregojne vleren, daten dhe blersin.
Stafi profesional Menaxher i projektit. 1.Inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - konstruktiv.	1. Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin. Menaxheri i projektit te deshmohet me nje deklarate nga OE.
2.Nje inxhinier i diplomuar i Arkitektures (ose master)	2.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.
3.Një inxhinier i diplomuar i Ndertimtarise (ose master) - hidroteknike	3.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.
4. Një inxhinier i diplomuar I Elektroteknikes (ose master)	4.Diplomë universitare (kopje të vërtetuar–origjinal) dhe kontratë të punës Valide ose marrëveshje mbi angazhimin.
5. Lista e mjeteve te punës dhe ate se paku - 1 eskavator, - Skele ndërtimi	5.Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto mjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me libreza te regjistrimit valide, fature per blerjen (me deshmi pagese), ose dud doganor në emër të kompanisë me të cilën konkuron ose marreveshje mbi qiramarrjen.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

(Tëpërshkruhetvetëmvlërësimi i ofertëssë OE ankues /ofertave, përtë cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Ne platformën elektronike nuk ka te krijuar raport vlerësimi, qe nënkupton se AK nuk e ka respektuar nenin 59 te LPP-së (Ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-sëLIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:OE"Olti Trasing"–Prishtinë

Pretendimi ankimor i OE ankues
OE ankues pretendon se AK ka bere shkeljen e LPP-se duke mos respektuar nenin 62 te LPP-se (Përfundimi i Procedurave te Prokurimit), nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se për procedurën e vlerësimit, pra AK nuk ka dhënë ndonjë arsyetim te eliminimit, por vetëm ka ngarkuar vendimin e AK-së për anulim te procedurës. AK nuk e ke respektuar nenin 7 te LPP-së – Barazia ne trajtim/jo diskriminimi, por ka vepruar njëanshëm duke e anluluar procedurën pa i trajtuar ofertat sipas nenit 59 te LPP-se. AK po ashtu ka bere shkeljen e nenit 108/A – Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve, sepse nuk i ka trajtuar/shqyrtuar kërkesat per rishqyrtim sipas pretendimeve ankimore, por OE e ka anuluar procedurën, pra AK e ka shkelur paragrafin 2 te nenit 108/A qe thotë (citim): Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar. Pra, AK duhet te shqyrtoj cdo kerkese per rishqyrtim sipas nenit 108/A te LPP-së. Autoriteti Kontraktues si arsye te anulimit te procedures ka sqaruar se: *Kerkese nga DA per anulimin e aktivitetit te prokurimit per arsye te mosperputhjes se projektit me paramasen ne nivele qe nuk mund te anashkalohen.* AK ka qene dasht te analizoj dhe te vendos para hapjes cdo ndryshim apo mospërputhje te projektit me "Njoftim per korrigjim te procedures", e jo te bej hapjen pa e harmonizuar projektin. Pra, anulimi i procedurës ka qene dashtë te behet para datës se hapjes sipas nenit 62 te LPP-se. Paragrafi 2.2 i nenit 62 te LPP-se thotë(citim): "para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve". Pra, eksperti i OSHP-se sqaron se lidhur me shkeljet e lartshënuara, pretendimi i OE ankues është i bazuar pasi qe nuk janë respektuar dispozitat e LPP-së. Pra, AK ne fazën e rivlerësimit te respektoj kriteret e FDT-së dhe NJpK-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelitshqyrtues që ankesa te aprovohete bazuar, dhe lënda te kthehet ne rivlerësim dhe AK ti respektoj kriteret e përcaktuaranga AK si ne FDT dhe NJK, sipas nenit 59 te LPP-së

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Komuna Ferizaj**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues -**OE. "Olti Trasing"– Prishtinë**